



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 20.03.2025

Numër Protokolli: 1993/2025

A.nr.264/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.264/2025, të datës 03.02.2025, të parashtruar nga ankuesi A.S, kundër organit të punësimit/Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.264/2025, e datës 03.02.2025, e parashtruar nga ankuesi A.S.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, A.S. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 01.02.2025, ka parashtruar ankesë në e-mailin zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e cila ankesë është regjistruar me datë 03.02.2025 dhe protokolluar me numër 726/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 30.01.2025, të rezultateve të testit me shkrim, lidhur me procedurën e rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00016068, për pozitën e punës “Drejtor i Departamentit për Digjitalizim të Shërbimeve në Komunës” në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa,

kjo i fundit, me datë 03.03.2024, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 16.12.2024, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00016068, për pozitën e punës “*Drejtor i Departamentit për Digjitalizim të Shërbimeve në Komunës*”, me afat aplikimi nga data 17.12.2024 deri më datë 15.01.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe duke qenë se ka plotësuar kriteret e konkursit i njëjti ka hyrë në listën e ngushtë dhe ka marrë pjesë në fazën e vlerësimit të testimit me shkrim, mirëpo sipas Njoftimit të 30.01.2025, rezulton se ankuesi nuk e ka kaluar testin me shkrim.

Andaj, kundër Njoftimit të datës 30.01.2025, lidhur me rezultatet e testit me shkrim ankuesi me datë 01.02.2025, ka parashtruar ankesë në e-mailin zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e cila ankesë është regjistruar me datë 03.02.2025, rrjedhimisht i njëjti kërkon që të verifikohet se a ka drejtë aplikimi për këtë pozitë kandidati i cili ka kaluar testin me shkrim, për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit ngase i njëjti ushtron këtë pozitë në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës si dhe po ashtu i njëjti kërkon qasje në shikimin e testit të tij.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 44 paragrafi 10 ku përcaktohet se: *10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankesë në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankesë në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi më datë 01.02.2025, kundër Njoftimit të datës 30.01.2025, lidhur me rezultatet e testit me shkrim, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka dorëzuar ankesën ende pa u publikuar Njoftimi i të datës 03.02.2025, për pozitën e punës “*Drejtor i Departamentit për Digjitalizim të Shërbimeve në Komunës*” në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e dorëzuar nga ankuesi me datë 01.02.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende

rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.264/2025, të datës 03.02.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.264/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.S;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.